



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

SENATI AKADEMIK

**RREGULLORE E BRENDSHME E SENATIT AKADEMIK, NË
UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË**

**Miratuar me Vendim Nr. 4, datë 16.01.2017
të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë**

TIRANË, 2017

RREGULLORE E BRENDSHME E SENATIT AKADEMIK TË UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË

Neni 1

Senati Akademik është organ kolegjal vendimmarrës, i zgjedhur, i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë (UMT). Veprimtaria e Senatit Akademik të UMT, mbështetet në Ligjin Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, dhe në Ligjin Nr.8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”.


Neni 2

Senati është organi kolegjal akademik më i lartë i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, përgjegjës për përmbushjen e misionit të tij, që përcakton politikat e zhvillimit, programon, bashkërendon, drejton dhe kontrollon veprimtaritë e mësimdhënies e të kërkimit shkencor, problemet administrativo-financiare si dhe vlerëson efikasitetin e tyre.

Neni 3

Drejtimet kryesore të veprimtarisë së Senatit Akademik janë:

1. Garanton respektimin e parimeve të autonomisë dhe mundësive të barabarta të lirisë akademike e të kërkimit shkencor, si dhe të drejtat e studentëve;
2. Miraton planin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore-shkencore dhe i propozon për miratim Bordit të Administrimit planin strategjik të zhvillimit të institucionit;
3. Miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, të hartuar nga rektorati, dhe ia përcjell atë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
4. Zgjedh përfaqësuesit e tij në Bordin e Administrimit;
5. Miraton paraprakisht planin buxhetor vjetor dhe afatmesëm.
6. Miraton Statutin e UMT, me dy të tretat e votave të anëtarëve të tij, pas miratimit më parë nga Bordi i Administrimit;
7. Harton strukturën e përgjithshme të UMT-së dhe i propozon Bordit të Administrimit numrin e personelit të institucionit në të gjitha nivelet;
8. Miraton rregulloret që janë kompetencë e tij, sipas përcaktimeve të bëra në Statutin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
9. Miraton programet e reja të studimit, të kërkimit shkencor, ndryshimet si dhe mbylljen e tyre.
10. Propozon mbylljen dhe riorganizimin e institucionit, si dhe ndarjen ose bashkimin e tij me një institucion tjetër të arsimit të lartë; miraton hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive të tij mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë. Në të gjitha këto raste merr vlerësimin paraprak të Bordit të Administrimit;
11. Garanton sigurimin e brendshëm të cilësisë, në përputhje me standardet shtetërore;
12. Krijon mekanizma për vlerësimin e veprimtarinë mësimore-kërkimore të personelit akademik;



13. Siguron që kontrolli dhe vlerësimi i dijeve të bëhen në përputhje me standardet e shprehura në Rregulloren e Universitetit, duke garantuar cilësinë dhe transparencën e nevojshme;
14. Miraton kuotat e pranimeve në Universitet, bazuar në kapacitetet pritëse të tij, si dhe tarifat e regjistrimit dhe të studimeve;
15. Kur e çmon të nevojshme, përcakton kriteret të veçanta në përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në ciklin e parë;
16. Miraton kriteret e pranimit për kandidatët në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve, sipas propozimeve të bëra nga Njësitë Kryesore të UMT-Së;
17. Përzgjedh anëtarët e Këshillit të Etikës së Institucionit;
18. Kërkon mendimin e Bordit të Administrimit për probleme që janë kompetencë e këtij të fundit;
19. Organizon mbledhjen e përbashkët, në bashkëpunim me Bordin e Administrimit, në fund të çdo viti akademik, ku diskutohet për veprimtarinë e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe atë financiarë;
20. Propozon dhe përzgjedh komisione të tjera të nevojshme për mbarëvajtjen e punës së UMT-së, si dhe komisione të tjera të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 4

Senati Akademik kryesohet nga rektori, i cili është kryetar i tij. Kryetari i Senatit drejton mbledhjet e tij, drejton diskutimet dhe siguron zbatimin e ligjit. Kryetari mund të shtyjë ose të mbyllë mbledhjen përpara kohe, në rastet kur situata e përiligj këtë veprim. Në mungesë të tij, mbledhjen e drejton zëvendëskryetari. Zëvendëskryetari zgjidhet një nga anëtarët e Senatit Akademik, me 2/3 e votave të anëtarëve të Senatit.

Neni 5

Senati Akademik përbëhet nga 21 anëtarë:


- 1 Rektori i Universitetit, i cili është dhe Kryetari i Senatit,
- 12 (dymbëdhjetë) përfaqësues nga Fakulteti i Mjekësisë,
- 4 (katër) përfaqësues nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike
- 2 (dy) përfaqësues nga Fakulteti i Mjekësisë Dentare
- 2 (dy) përfaqësues të studentëve (10 %),

Neni 6

Në mbledhjet e Senatit Akademik marrin pjesë të gjithë anëtarët e tij dhe sekretarja që mban procesverbalin e mbledhjes.

Neni 7

Në mbledhjet e Senatit mund të marrin pjesë pa të drejtë vote edhe zv/rektori ose zv/rektorët, kur nuk janë anëtarë të zgjedhur të Senatit Akademik, si dhe Administratori i Universitetit. E njëjta gjë edhe për dekanët e fakulteteve përbërës të UMT-së, që nuk janë anëtarë të Senatit.



Neni 8

Për të lehtësuar funksionimin e brendshëm të Senatit Akademik, ngrihen komisione të posaçme ad-hoc në varësi të problematikave që kërkojnë një diskutim të detajuar. Çdo komision zgjedh kryetarin/en e tij. Në rast të mosfunksionimit të tyre, shpërbehen me vendim të senatit dhe krijohen rishtazi po nga ai.

Neni 9

Komisionet e posaçme të Senatit Akademik përbëhen, si rregull, nga anëtarë të zgjedhur të tij. Në përbërje të tyre mund të përfshihen edhe specialistë të fushave përkatëse, por gjithmonë jo më shumë se 1/3 e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të komisionit dhe në asnjë rast nuk i kryesojnë këto komisione. Anëtarët e komisioneve vetëkandidohen ose propozohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik.

Neni 10

Senati mbledhet në mënyrë periodike, një herë në muaj. Njoftimi i anëtarëve të Senatit bëhet në mënyrë elektronike. Mbledhja kryesohet nga Kryetari i Senatit Akademik. Në rastet kur Kryetari i Senatit nuk është i pranishëm, mbledhja kryesohet nga zëvendëskryetari.

Neni 11

Senati mund të mbledhet edhe në seanca të jashtëzakonshme, me nismën e kryetarit ose me kërkesën e 1/3 së anëtarëve të tij. Në këto raste, rendi i ditës propozohet nga grupi i anëtarëve propozues.

Neni 12

Mbledhjet e Senatit dhe të komisioneve të tij, janë të vlefshme kur janë të pranishëm jo më pak 50%+1 e anëtarëve të tij me përjashtim të rasteve kur vendimmartja kërkon shumicë të cilësuar.

Neni 13


Votimet në Senat mund të jenë të hapura ose të fshehta. Për çështjet e zakonshme votimi është i hapur. Në rast se votat pro dhe kundër, për një çështje të caktuar, janë në numër të barabartë, vendimtare është vota e Kryetarit të Senatit. Për çështje që anëtarët e Senatit i konsiderojnë të rëndësishme, kur bëhet fjalë për persona, kandidatë për pozicione të caktuara drejtuese, komisione apo borde, kur kërkohet nga Kryetari i Senatit ose 1/3 e anëtarëve të tij, votimi bëhet i fshehtë.

Neni 14

Mbledhjet e Senatit thirren me një rend dite të përcaktuar, të propozuar nga Kryetari i Senatit ose nga organizatorët në rastet kur 1/3 e senatorëve e kërkon mbledhjen. Rendi i ditës i shpërndahet të gjithë anëtarëve të paktën 72 (shtatëdhjetë e dy) orë përpara datës dhe kohës së mbledhjes në mënyrë elektronike.

Neni 15

Procedura e mbledhjes së Senatit dhe diskutimet e zhvilluara në të, pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes, i cili nënshkruhet nga kryetari dhe mbajtësi i tij.



Neni 16

Anëtarët e Senatit kanë të drejtë e fjalës për çdo gjë që diskutohet në Senat. Për diskutimin e çdo pike të rendit të ditës, si rregull, fjala merret vetëm një herë. Përjashtim bëhet kur kërkohet fjala në rast replike.

Neni 17

Vendimet e Senatit Akademik hartohen në dy kopje dhe nënshkruhen nga kryetari i Senatit. Një kopje arkivohet dhe tjetra i dërgohet njësisë/njësive përkatëse për zbatim.

Neni 18

Mandati i Senatit është 4-vjeçar. Mandati i anëtarit të Senatit merr fund:

- Me mbarimin e afatit;
- Me dorëheqje;
- Kur ndërpret marrëdhëniet pedagogjike, studimore apo të punës me UMT;
- Kur mungon pa arsye radhazi, në 6 seanca mbledhjesh të tij;
- Kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Vdes.

Vendi i mbetur vakant plotësohet sipas renditjes në listën përkatëse të kandidatëve gjatë votimit për Senatin Akademik në UMT. Kur nuk ka të tillë, Rektori thërret zgjedhjet për anëtar të Senatit Akademik.

Neni 19

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit në Senatin Akademik të UMT dhe nënshkrimit nga Kryetari i tij.

Miratuar me Vendimin Nr. 41 të Senatit Akademik të UMT, datë 16.01.2017

REKTORI

PROF. ARBEN GJATA

